

**MIRATUAR**

**MINISTRI**

**Ylli PANGO**

**R R E G U L L O R E**

**PËR  
KËRKESAT PËR PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E NJËSIVE AKOMODUESE DHE  
RESTORANTEVE TURISTIKË**

**Neni 1**

Subjekt i kësaj rregulloreje janë të gjithë personat fizikë/juridikë që ushtrojnë veprimtari si njësi akomoduese dhe restorant turistik

**Neni 2  
Të përgjithshme**

“Njësi akomoduese”, është ndërtesa ku ofrohet akomodimi i turistëve.

“Restorant” , është një ndërtesë, ku i ofrohet ushqim dhe pije për konsumim brenda mjedisit, çdo udhëtari që paguan për këtë shërbim.

“Punime ndërtimi”, quhen të gjithë punimet e ndërtimit për ndërtesat, objektet qytetare, veprat industriale dhe lloje të tjera.

Projektimi, mbikqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për objektet kontrollohen dhe disiplinohen nga dispozitat e ligjit Nr.8402, datë 10.09.1998/ ndryshuar me ligjin Nr.9200, datë 26.02.2004 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. Ky ligj zbatohet për të gjitha projektimet dhe ndërtimet që realizohen nga persona fizik/juridik vendas ose të huaj, në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3  
Projektimi, mbikqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimeve**

Objektet e përkufizuara në nenin 2 të kësaj rregulloreje, ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë dhe juridikë të pajisur me liçencën përkatëse. Personat kryesor për ndërtimin janë:

- Investitori
- Sipërmarrësi
- Projektuesi
- Mbikqyrësi i punimeve

Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve nga institutet shtetërore ose ente të tjera të specializuara.

Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikqyrësi i punimeve. Ai emërohet nga investitori dhe është një person fizik/juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me liçencën përkatëse dhe që nuk është i lidhur me zbatuesin e objektit.

Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet nga personat juridikë privat vendas ose të huaj, të pajisur me liçencën përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit. Zbatuesi ka përgjegjësinë që objekti të ndërtohet në përputhje me projektin, kushtet teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.

Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 2 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko – ekonomik. Kolaudatori është person fizik/juridik vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur me projektimin, mbikqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit.

#### **Neni 4 Kërkesat themelore**

Punimet e ndërtimit duhet të projektohen dhe zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me vendodhjen e tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me:

##### **A. Njësitë Akomoduese**

1. Minimumi i sipërfaqes së dhomës \*
2. Minimumi i sipërfaqes së suitës \*
3. Minimumi i sipërfaqes për njësitë vetshërbyese \*

\* Minimumet e sipërfaqeve janë përcaktuar në Rregulloren “Për kërkesat e regjistrimit dhe klasifikimit të njësive akomoduese”.

4. Parashikimin e hapësirave për tualetet në varësi të standarteve që kërkon të plotësojë njësia akomoduese.
5. Marrjen e masave për mbrojtjen kundër zjarrit, në përputhje me VKM – në Nr. 699, datë 22.10.2004 “Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike”.
6. Parashikimin e hapësirave të nevojshme për barin/et dhe restorantin/et, në varësi të standarteve që kërkon të plotësojë njësia akomoduese
7. Parashikimin e hapësirës për kuzhinën dhe dhomat e magazinimit të produkteve (Sipas përcaktimeve të dhëna në Rregulloren “Për kërkesat e regjistrimit dhe klasifikimit të njësive akomoduese”).
8. Parashikimin e hapësirave për parkim në varësi të standarteve që kërkon të plotësojë njësia akomoduese.
9. Ashensorët, në varësi të kateve dhe të standarteve që kërkon të plotësojë njësia akomoduese.
10. Krijimin e lehtësirave në lëvizjen në ambjentet e njësive akomoduese për njerëzit me aftësi të kufizuara.
11. Mbrojtjen ndaj zhurmave.
12. Kursimin e energjisë, ruajtjen e nxehtësisë dhe krijimin e shfrytëzimit të burimeve të tjera alternative të energjisë.
13. Higjenën, mjedisin dhe shëndetin, ku përfshihet dhe parashikimi i hapësirave për mbajtjen e mbeturinave, para heqjes së tyre.
14. Parashikimin e hapësirave për lavanerinë dhe shërbime të tjera, në varësi të standarteve që kërkon të plotësojë njësia akomoduese.
15. Parashikimin e hapësirave për ambjentet sportive, argëtuese, pishinat dhe të tjera.

##### **B. Restorantet Turistikë**

1. Parashikimin e hapësirës për barin dhe aksesoret e tij.
2. Parashikimin e ambjentit/eve të ngrënies i/të aplikueshëm në çdo ambjent, brenda dhe jashtë.
3. Parashikimin e hapësirës së përcaktuar për kuzhinën me të gjithë aksesoret dhe me hyrje të veçantë për personelin dhe furnizimin.
4. Marrjen e masave për mbrojtjen kundër zjarrit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
5. Parashikimin e hapësirës për tualetet publike.
6. Parashikimin e hapësirës për tualete dhe dhoma për personelin

7. Parashikimin e hapësirës për parkim.
8. Parashikimin e hapësirave për ambiente magazinimi të mallit në përshtatje me llojin e mallit (Sipas përcaktimeve të dhëna në Rregulloren "Për kërkesat e regjistrimit dhe klasifikimit të restoranteve turistike").
9. Parashikimin e hapësirave për grumbullimin e mbeturinave në përshtatje me kushtet higjieno – sanitare.
10. Parashikimin e vendosjes së ashensorit në rastet e vendodhjes së restoranteve në kate të larta ndërtese.

#### **Neni 5**

#### **Dispozita të fundit**

Ndryshimet në këtë rregullore, bëhen me propozim të strukturës përgjegjëse në MTKRS dhe të KST, dhe miratohen nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.